



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 643/5 Prot

Tiranë, më 13 . 10 .2025

V E N D I M

Nr. 43 , datë 13 / 10 /2025

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Himarë dhe paralajmërimit të institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës.”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në institucionin e Bashkisë Himarë,

V Ë R E J S E:

Me urdhrin nr. 60, datë 26.6.2025 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Himarë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 643/1 prot., datë 26.6.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Himarë me shkresën nr. 643/2 prot., datë 26.6.2025 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Himarë”.

- konstatohen parregullsi në veprimet administrative që duhet të kryhen gjatë aplikimit të institutit të periudhës së provës:

a) rezulton se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe, si rezultat, mungon mendimi me shkrim i tij;

b) në formularin e vlerësimit vjetor të punës, të nëpunësit civil në periudhë prove, mungojnë komentet e zyrtarit raportues, të cilat janë element i nevojshëm për të vlerësuar objektivitetin e zyrtarit në përcaktimin e nivelit të vlerësimit të rezultateve në punë gjatë kësaj periudhe;

c) në aktet e vlerësimit të punës, nuk janë plotësuar në mënyrë të saktë dhe të qartë të gjitha të dhënat që kërkojnë në ndarjet e formularit dhe ku të jenë nënshkruar nga të gjithë zyrtarët e vlerësimit dhe nëpunësi i vlerësuar.

Komisioneri vlerëson se, mangësitë e konstatuara gjatë mbikëqyrjes, duhet të rregullohen dhe njësia e burimeve njerëzore e institucionit, e cila e ushtron funksionin e saj në përputhje me të gjitha rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, gjatë veprimtarisë së saj, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë të angazhuar me detyra të administrimit të shërbimit civil, duhet të zbatojnë me korrektësi të gjitha kërkesat e ligjit për nëpunësin civil.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbytjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave në administrimin e shërbimit civil, në institucionin e Bashkisë Himarë, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën sipas detyrave që do të evidentohen në vijim.

të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimi në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

- **Kostaq Dhima**, emëruar me aktin nr. 1291, datë 05.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist IT*”;
- **Lazaro Gjini**, emëruar me aktin nr. 111, datë 08.01.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për turizmin*”;
- **Fotika Leka**, emëruar me aktin nr. 5, datë 08.01.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për turizmin*”;
- **Andonia Rondo**, emëruar me aktin nr. 1598 prot., datë 14.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për dhunën në familje*”;
- **Arilda Hamza**, emëruar me aktin nr. 350 prot., datë 16.06.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për dhunën në familje*”;
- **Kostandino Çela**, emëruar me aktin nr. 1292, datë 05.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist jurist*”;
- **Meriglana Gega**, emëruar me aktin nr. 1183, datë 03.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist jurist*”;
- **Ergis Papaproko**, emëruar me aktin nr. 264 prot., datë 09.4.2025, të titullarit, në pozicionin “*Përgjegjës sektori integritetit europian dhe projekteve të huaja*”;
- **Klaudia Fikaj**, emëruar me aktin nr. 1820 prot., datë 24.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për BE*”;
- **Ematina Husi**, emëruar me aktin nr. 1562 prot., datë 13.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për BE*”;
- **Emanuela Shirokaj**, emëruar me aktin nr. 270 prot., datë 13.01.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist për administrimin e aseteve*”;
- **Migena Hajdini**, emëruar me aktin nr. 1563 prot., datë 13.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist finance*”;
- **Flobens Dilaveri**, emëruar me Urdhër nr. 348, datë 13.6.2025, të titullarit, në pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e të Ardhurave;
- **Kreshnik Kuçi**, emëruar me aktin nr. 369, datë 24.6.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist i taksave*”;
- **Megi Dervishhasani**, emëruar me aktin nr. 370 prot., datë 24.6.2025, të titullarit, në pozicionin “*Përgjegjës sektori i kontrollit dhe vlerësimit*”;
- **Kristo Bala**, emëruar me aktin nr. 163 prot., datë 27.02.2025, të titullarit, në pozicionin “*Specialist kontrolli dhe vlerësimi*”;

7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **4 (katër) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

8. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Himarë, Prefekti i Qarkut Himarë, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjensia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Himarë, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

9. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Pranvera Strakosha